



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vendim. nr. 01/1435 /Dt. 29/07 /2022

Në bazë të nenit 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.19 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, dhe nenit 33 paragrafi 1 i Ligjit të Punës dhe në koordinim me Sekretarin e përgjithshëm të UKZ-së, marr këtë

V E N D I M

**për shfrytëzimin e pushimit vjetor për personelin akademik dhe administrativ të
Universitetit Publik "Kadri Zeka" për vitin 2022**

1. Pushimi vjetor për personelin akademik të pesë (5) njërive akademike të UKZ-së, nga data 01.08.2022 deri më 31.08.2022.
2. Pushimi vjetor për personelin administrativ të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan do të shfrytëzohet nga data 01.08.2022 deri më 31.08.2022.
3. Kthimi në punë nga pushimi vjetor do të bëhet me datë 01.09.2022.
4. Personeli që i takon kategorisë si në paragrafin 4 të këtij vendimi, pas shfrytëzimit të pushimit vjetor në kohëzgjatje prej 20 ditëve, do të rikthehen në vendet e tyre të punës.
5. Pushimi vjetor mund të shfrytëzohet deri me 30 Qershor të vitit të ardhshëm, në dy (2) apo më shumë pjesë.
6. Zyra e financave, prokurimit dhe TI-së, gjatë periudhës së pushimit do t'i kryejnë vetëm shërbimet esenciale. Udhëheqësit e zyrëve përkatëse, janë të obliguar që gjatë kohës së pushimit vjetor të caktojnë me rotacion një nëpunës i cili do të kryej shërbimet esenciale, ndërsa nëpunësit obligohen që të mbajnë evidencë për ditët e punës.
7. Zyra për diploma gjatë kohës së pushimit vjetor do të punojë një ditë në javë sipas njoftimit nga zyrtari i diplomave i cili do t'i kryej shërbimet e dhënies së diplomave të nënshkruara

nga personat e autorizuar, ndërsa nëpunësit obligohen që të mbajnë evidencë për ditët e punës.

8. Udhëheqësi i zyrës së shërbimit studentor është i obliguar që gjatë kohës së pushimit vjetor të caktojë me rotacion një nëpunës që mbulon pozitën e zyrtarit për shërbime studentore, ndërsa zyrtarët përkatës obligohen që të mbajnë evidencë për ditët e punës.
9. Menaxheri i personelit, obligohet që për secilin nëpunës administrativ të UKZ-së të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2022.
10. Sekretari Përgjithshëm, drejtorët e zyreve, udhëheqësit e zyrave dhe menaxheri i personelit obligohen që të përgatisin kalendarin e angazhimit të personelit që do të punojë gjatë pushimit vjetor.
11. Përjashtim nga paragrafi 1 Komisionet recensuese mund të punojnë edhe gjatë muajit gusht dhe për ditët e punës evidencën do ta mbajë dekani i njësisë akademike.
12. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Menaxhmentit të UKZ-së;
2. Sekretarit të përgjithshëm të UKZ-së;
3. Drejtorëve të shërbimeve ;
4. Menaxherit të personelit të UKZ-së;
5. Publikohet në www.uni-gjilan.net



Prof. Dr. Bajram Kosumi

Rektor i UKZ-së